



Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “*AGI KONS*” shpk & “*MET ENGINEERING*” shpk & “*ZENIT&CO*” shpk
Adresa: Kodra e Diellit II, Godine e kombinuar 4 kat+ 1 kat nentoke, nr. pasurie 51/159, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESI

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat: “**Procedurë e Hapur mbi Kufirin e lartë monetar**”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës**” “**Për Projektimin , Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1**”

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Operatori Ekonomik “SENKA” shpk

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte

2. Operatori Ekonomik “FILIPPETI s.p.a”

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferte

3. Operatori Ekonomik “Bruçi” shpk

NUIS - J61826102J

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik:

1.793.353.970 (një miliard e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik J.V “AGI KONS” shpk & “MET ENGINEERING” shpk & “ZENIT&CO” shpk

NUIS- K21622001M NUIS-L52025007R NUIS-K61731002D

Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve:

1. Oferta ekonomike për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe mbikqyrjen **1.600.861.766,83**(një miliard e gjashtëqind million e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH
2. Oferta ekonomike për mirëmbajtjen deri në fund të kontratës **339.760.806**(treqind e tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë pa TVSH
3. Oferta ekonomike për marzhin e fitimit **6.28%**(gjashtë presje njëzet e tetë përqind)

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

- **Operatori Ekonomik “SENKA” shpk**
- **Operatori Ekonomik “ FILIPPETI” S.P.A**
- **Operatori Ekonomik “ BRUÇI” shpk**

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “SENKA” shpk

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Koncesionit/PPP konstatoi se shoqëria “SENKA” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga Komisioni u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës financiare dhe e dokumentacionit ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “SENKA” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Ofertës Financiare sipas Shtojcës 1 kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të koncensionit për këtë procedurë

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “FILIPPETI S.P.A”

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Koncesionit/PPP konstatoi se shoqëria “FILIPPETI S.P.A” nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga Komisioni u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës financiare dhe e dokumentacionit ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “FILIPPETI S.P.A” s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Ofertës Financiare sipas Shtojcës 1 kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të koncensionit për këtë procedurë.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Bruçi” shpk

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Ligjit nr.125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, (i ndryshuar), nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të koncesionit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori Ekonomik “BRUÇI” shpk nuk ka paraqitur ofertën ekonomike sipas formatit të kërkuar nga AK, Bashkia Tiranë.
- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Koncesionit/PPP konstatoi se shoqëria “**BRUÇI**” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 9932 Prot. datë 14.11.2017 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në muajin tetor pra pa përfshirë faturën koherente të muajit tetor 2017 dhe Nentor 2017.Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.
- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërtetoi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Tetor 2017, Nentor 2017.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “**BRUÇI**” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “f” të vendosur në DSK, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, tëkonfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Së dyti nga verifikimi i dokumentave të ngarkuara në sistemin elektronik të app-së rezulton se operatori ekonomik “BRUÇI” shpk nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3 të kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit/PPP/Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1 gërma a.

Së treti, AK në dokumentat Standarte të Koncesionit ka kërkuar si më poshtë:

- a. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për Bashkinë Tiranë të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016, 2017;

Nga verifikimi i dokumentave të ngarkuara nga ana e operatorit ekonomik të mësipëm në sistemin elektronik të app-së rezulton se shoqëria nuk ka paraqitur në përmbushje të kriterit të mësipërm Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga taksave vendore për Bashkinë Tiranë të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016, 2017 ashtu sic edhe është kërkuar në dokumentat Standarte të Koncesionit.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar duke mos

paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për Bashkinë Tiranë të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016, 2017 të kërkuar nga AK.

Së katërit

AK, në dokumentat Standarte të Koncesionit ka kërkuar si më poshtë:

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Eksperiencë në Ndërtim

Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 30% e vlerës së përlllogaritur të zërave përkatës të kontratës object Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 419.987.432 (katërqind e nëntëmbëdhjetë million e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

ose

b. punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës së përlllogaritur të zërave përkatës të kontratës object Koncesioni/PPP dhe konkretisht: 2.799.916.214 (dy miliard e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë million e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e katërmëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr.7, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Certifikaten e marrjes ne dorezim.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 7, shoqëruar me:
2. Kontrate;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Certifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
5. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Të dy pikat e mësipërme, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. Eksperiencë në mirëmbajtjeje

Operatori ekonomik ose bashkimi I operatorëve ekonomikë duhet të paraqesi si më poshtë:

1. Shërbime të ngjashme me objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat me vlerë jo më të vogël se 10% e vlerës së përlllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: 33.979.580 (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.

b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

c. Eksperiencë në Projektim

Operatori ekonomik ose bashkimi I operatorëve ekonomikë duhet të paraqesi si më poshtë:

a. Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik, në vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të shërbimeve të parashikuara në project, dhe perkatësisht 7.078.726 (shtatëmilion e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzetë e gjashtë) leke.

Kur kontratat janë të realizuara me institucione shtetërore ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e lidhur me Institucionin të shoqëruar me vërtetimet nga institucioni me të cilin janë nënshkruar këto kontrata mbi realizimin me sukses të tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.

Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara, të firmosura dhe të vëlosura nga të dy palet).

d. Eksperiencë në Furnizimin dhe vendosjen e mobiljeve , orendi dhe paisjeve laboratorike
Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të eksperiencës të parashikuara në project ose 29.558.176 (njëzetë e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Kur kontratat janë të realizuara me institucione shtetërore ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e lidhur me Institucionin të shoqëruar me vërtetimet nga institucioni me të cilin janë nënshkruar këto kontrata mbi realizimin me sukses të tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.

Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara, të firmosura dhe të vëlosura nga të dy palet).

Operatori Ekonomik në përmbushje të kapacitetit teknik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë që të vërtetojë përmbushjen e kriterit të kapacitetit teknik (a.Eksperiencë në Ndërtim, b. Eksperiencë në mirëmbajtjeje, c. Eksperiencë në Projektim, d.

Eksperiencë në Furnizimin dhe vendosjen e mobiljeve , orendi dhe paisjeve laboratorike)

Pra sa më sipër cituar shoqëria BRUÇI shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme në realizimin e Kontratave **në Ndërtim, në mirëmbajtjeje, c.**

në Projektim, në Furnizimin dhe vendosjen e mobiljeve , orendi dhe paisjeve laboratorike)për të realizuar kontratën për këtë procedurë Koncesioni/PPP duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 2.3 germa a,b,c,d, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Së pesti Ak, në dokumentat Standarte të Koncesionit/PPP ka kërkuar si më poshtë:

1. Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

a. Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategorite:

2/a (Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale – turistike-vepra arti në infrastrukturë.)

2/b (Projektim arkitektonik për objekte sportive)

2/d (Projektim peisazhi,sistemim sipërfaqe të gjelberta,lulishte e parqe)

3/a(Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.)

3/c(Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.)

4/a(Instalime hidrosanitare.)

4/b(Instalime termoteknik – ventilimi - kondicionimi.

4/c(Linja e rrjeta elektrike – telefonike – radiotelefoni – citofoni –sistem alarmi – televiziv etj, për objekte civile, industriale, turistike)

6/a(Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.)

8/a(Bazamente gjeodezike – rivelime në të gjitha shkallët)

8/b(Projektim fotogrametrik – hartografik - topografik.)

9/a(Studim/Vlerësim gjeologjiko inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.)

10/c(Implante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj.)

10/e (Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.)

11/a(Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Shoqëria Bruçi shpk në dokumentacionin e paraqitur elektronikisht, nuk ka paraqitur Liçencë të shoqërisë për projektim të vlefshme për kategoritë e kërkuara. Në këtë mënyrë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria Bruçi shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 1 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, për rrjedhojë nuk mund të quhet i vlefshëm nga autoriteti kontraktor

Për sa më sipër cituar operatori ekonomik Bruçi shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket kualifikimi profesional për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1 cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, përveprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

Së gjashti, AK në dokumentat standarte të koncesionit ka kërkuar si më poshtë:

2. Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorie si me poshte shenuar, shoqeruar patjeter me cv, kontratat individuale te punes (të vlefshme), si dhe stafi i mëposhtëm duhet të ketë eksperiencë të paktën 5 vite në sektoret përkatës

- Projektues Arkitekt me Kat 2/a/b/d (2/a (Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale – turistike-vepra arti në infrastructure, projektim arkitektonik për objekte sportive, projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe)
- Projektues Konstruktor me Kat 3/a/c (Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate , Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.)
- Projektues Instalator me Kat 4/a/b/c ((Instalime hidrosanitare, Instalime termoteknik – ventilimi – kondicionimi, Linja e rrjeta elektrike – telefonike – radiotelefoni – citofoni – sistem alarmi – televiziv etj, për objekte civile, industriale, turistike)
- Projektues Rrugë-Hekurudha me Kat 6/a. (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.)
- Projektues Gjeodet me Kat 8/a/b (Bazamente gjeodezike – rivlime në të gjitha shkallët, Projektim fotogrametrik – hartografik - topografik).
- Projektues gjeollogo inxhinierik –hidrogjeologjiko me Kat 9/a (Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate)
- Projektues i Impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë me Kat. 10/c/e ((Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj, Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.)
- Projektues të sinjalizimit rrugor me Kat 11/a (Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)

- Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e koncesionit /PPP.

Operatori ekonomik Bruçi shpk në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur Liçenca profesionale të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.

Për sa më sipër cituar operatori ekonomik Bruçi shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 5, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,,reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Së shtati AK në dokumentat Standarte të Koncesionit ka kërkuar si më poshtë:

2.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1 A (Punime gërmimi në tokë)
- N.P – 2F (Ndërtime civile dhe industriale.)
- NP-3 C (Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale)
- NP- 11A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve linja të tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

• NP- 12A (Punime te inxhinierise se Mjedisit)

NS1-A(Punime per prishjen e ndertimeve)

- NS – 2C (Impiante hidro – sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre)
- NS-3A(Impiante ngritëse transportuese)
- NS – 4E (Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)
- NS-8A(Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)
- **NS-9C(Punime te posacme strukturore)**
- NS-12 A (Impiante teknologjike,termike dhe kondicionimi)
- NS-13A(Implementimi i linjave telefonike dhe sistemeve te telekomunikacionit)
- NS- 14A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj)
- **NS-18A (Punime Topogjeodezike).**
- NS-19A(Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore)

- sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Operatori Ekonomik “Bruçi” shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Liçencën e shoqërisë por nga verifikimi i licences u vu re se mungonin kategorite e mëposhtme:

NS-9C(Punime te posacme strukturore)

NS-18A (Punime Topogjeodezike).

Në këtë mënyrë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria Bruçi shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 1 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, për rrjedhojë nuk mund të quhet i vlefshëm nga autoriteti kontraktor

Për sa më sipër cituar operatori ekonomik Bruçi shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket kualifikimi profesional për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1 cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....

- a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, përveprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

Së teti, Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Koncesionit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 4 si më poshtë cituar:

Një punësim mesatar i të paktën **300 (treqind)** personave, për periudhën **Shtator 2015 - Shtator 2017** të vërtetuar me;

Shoqëria “BRUÇI” shpk në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore me Nr.prot TR00045597, datë 05.12.2017 për muajt Shtator 2015-Shtator 2017 si dhe në list pagesat për periudhën Shtator 2015-Shtator 2017 rezulton të ketë një numër mesatar prej 43 punonjësish.

Sa më sipër cituar për realizimin e objektit të mësipërm duhet të angazhojë 300 punonjës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të koncesionit. Pra sa më sipër shoqëria “BRUÇI” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4/, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që AK i vlerëson të nevojshme.....b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën. AK në dokumentat Standarte të Koncesionit ka kërkuar si më poshtë cituar:

- Së nënti, *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Koncesionit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:*

Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të pakten **50 (pesëdhjetë) punonjës** të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- 10 (dhjetë) punonjës
- Grupi II-34 (tridhjetë e kater) punonjës
- Grupi III- 2(dy) punonjës
- Grupi IV-2 (dy) punonjës
- Grupi V- 2 (dy) punonjës
- **(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik)**
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 6(gjashtë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit, për manovratorët duhet të paraqesin gjithashtu dhe dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) nga të cilat tre dëshmi të jenë për automakinistë dhe tre të tjerat eskavatoristë, lëshuar nga institucionet përkatëse)*

Operatori ekonomik i mesiperm nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnjë punonjes të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të

Pra referuar sa më shoqëria nuk ka paraqitur asnjë punonjës me kategoritë e mësipërme. Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Së nënti, Në dokumentat standarte të Koncesionit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik citohet:

- **5** Te kete ne staf te punësuar dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë:
 - a. Inxhinier – Auditues energjie 1 (një)person (të pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise)
 - b. ekspert zjarrfikes te certifikua 1(një) person

- (Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise, Diploma, për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit).

Shoqëria Bruçi shpk nuk ka paraqitur elektronikisht inxhinier auditues dhe nuk ka paraqitur ekspert zjarrfikës si staf të punësuar pranë shoqërisë. Për sa më sipër cituar operatori ekonomik BRUÇI shpk nuk zotërojnë kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën e koncesionit /PPP duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

b)Aftësia teknike;Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,,reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe **personelin e nevojshëm** për të zbatuar kontratën.

Së dhjeti, nga verifikimi i dokumentave në sistemin elektronik për operatorin e mësipërm rezulton se shoqëria BRUÇI shpk nuk ka paraqitur si më poshtë:

9. Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten PAS 99-2012 (e vlefshme).

11. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 27001-2013 (e vlefshme)

12. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 50001 -2011 (e vlefshme).

13. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO EN3843-2-2006 (e vlefshme).

14.Operatorët Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë koncesioni/PPP duhet të paraqesin certifikatat e produktit konform standarteve europiane për artikujt respektivë si më poshtë:

1.Tavolinë nxënësi(banke nxenesi) cikli I ulët , I mesëm EN 1729-1:2006, EN 1729-2:2006

2.Karrike nxënësi cikëli I ulët, I mesëm dhe I lartë EN 1729-1:2006, EN 1729-2:2006

3.Dollap/Etazher EN 14073-3:2004:

4.Karrike mësuesi EN 1335-1:2000, EN 1335-2:2009, EN 1335-3:2009

5.Tabelë shkrimi(dërrasë e zezë) EN 71-3:2014

Së njëmbëdhjeti, AK në dokumentat standarte të koncesionit ka kërkuar dëshmi për mjetet që nevoiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8)

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës për secilin kamion minimum 15(pesembëdhjetë) ton dhe maksimumi 22(njëzetë e dy) ton)	8 copë	Pronësi ose me qera
Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë minimumi 2 ton dhe maksimumi 5 ton	6 cope	Pronësi ose me qera

Fadrome me Goma	4 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	4 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me Goma	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	5 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë e vogël/Minifadrome	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion)	5 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Frezë Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat Topografik Stacion Total për punimet topogjeodezike	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinxh	2 copë	Pronësi ose me qera
Betonforma	1500 m2	Pronësi ose me qera
Matrapik	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	3 cope	Pronësi ose me qera
Depozite uji (500 L secila)	5 cope	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) te kompletuara me parapet mbrojtës dhe rrjete mbrojtëse per punime ne fasade	1500 m2	Pronësi ose me qera
Prerese asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Aparat Saldimi	3 cope	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Fabrike Prodhim Betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul Gome Cilinder per ngjeshje me Vibrim	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul Cilinder Cilinder per ngjeshje me Vibrim	1 cope	Pronësi ose me qera
Vinc kulle me lartesi min 30 ml me peshmbajtje te pakten 850 kg ne 35 ml distance	4 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak per ngjeshje dheu (Motor me karburant ose elektrik)	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik ka paraqitur shtojcën 8 dhe në përmbushje të saj ka paraqitur elektronikisht dokumentacion të saktë vetëm për kamionçinën më tërë TR 4169 K me tonazh 3.1 TON. Pra sa

më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 8 , është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Së dymbëdhjeti, AK në dokumentat standarte të koncesionit ka kërkuar si më poshtë:

Kujdes: Operatorët Ekonomikë pjesmarrës në procedurën koncesionare /PPP duhet ti ofrojnë Autoritetit Kontraktor tre shoqëri supervizioni si dhe tre kolaudator (person fizik ose person juridik), në rastin e shpalljes fitues në këtë procedurë Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të përzgjedhur kush do të mbikqyrë punimet si dhe do të kolaudojë objektet. Për shoqëritë e supervizionit Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentat si më poshtë:

- Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga MPPT) ose Kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategori:
 - NP – 1 (Punime gërmimi në tokë)
 - N.P – 2 (Ndërtime civile dhe industriale.
 - NP-3 (Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale)
 - NP- 11 (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve linja të tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)
 - NP- 12(Punime te inxhinierise se Mjedisit)
- NS-1(Punime per prishjen e ndertimeve)
 - NS - 2(Impiante hidro – sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre)
 - NS-3(Impiante ngritëse transportuese)
 - NS – 4(Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)
 - NS-8(Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri)
 - NS-9(Punime te posacme strukturore)
 - NS-12 (Impiante teknologjike,termike dhe kondicionimi)
 - NS-13A(Implementimi i linjave telefonike dhe sistemeve te telekomunikacionit)
 - NS- 14 (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj)
 - NS-18 (Punime Topogjeodezike).
 - NS-19(Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore)

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Si dhe

- **Eksperience në mbikqyrje punimesh**

1. Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të shërbimeve të parashikuara në project dhe konkretisht: **6.344.483** (gjashtë milion e treqind e dyzete e kater mije e katerqind e tetedhete e tre) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (*ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*).

Nga verifikimi i dokumentatve të koncesionit të ngarkuara në sistemin elektronik të app-së rezulton se shoqëria Bruçi shpk nuk ka paraqitur asnjë shoqëri supervizioni apo kolaudator ashtu siç edhe është kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Bruçi” shpk lidhur me sa më sipër mungon

* * *

Bashkia Tiranë lajmëron se oferta e paraqitur më datë 08.01.2018 nga **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “AGI KONS” shpk & “MET ENGINEERING” shpk & “ZENIT&CO” shpk**, me adresë:, Tiranë, Kodra e Diellit II, Godine e kombinuar 4 kat+ 1 kat nentoke, nr. pasurie 51/159, për marrjen me koncesion/PPP te objektit **“Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin , Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1”** është pranuar.

Afati i negociimit te Kontrates tuaj do te jete **2 (dy) muaj**

Ofertuesi **“AGI KONS” shpk & “MET ENGINEERING” shpk & “ZENIT&CO” shpk** kërkohet t’i paraqesë Bashkia Tiranë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Pergjithshme dhe te Vecanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.

Dokumenta Standarde te Koncesionit\Partneritetit Publik Privat

- Sigurimin e Kontrates sipas formes se kerkuar ne Dokumentat Standarte te Procedures Konkurruese. Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nenshkrimit te Kontrates nga te dy palet.
- Dokument bankar qe verteton pagesen e kryer per shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulences se specializuar (*ne rast se ka*). Kjo pagese do te kryhet para fillimit te negociatave.
- Ne rast se, terhiqeni nga lidhja e kontrates duhet te njoftoni me shkrim.

Autoriteti kontraktues; Bashkia Tiranë

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.02.2018

Ankesa: Nuk ka patur ankesa

